

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPËSTINA VUÇITRAN

02 Nr. / Br 1682/24

Nr. i fq. / Br. sf \_\_\_\_\_

Data: / Datum 11.11.2024

VUSHTRRI - VUÇITRAN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, me 28/04, qershor 2008), nenit 43 paragrafi 1 pika 14 dhe nenit 44 paragrafi 1 i Statutit të Komunës, si dhe propozimit të Drejtorisë për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural dt. 11.11.2024, Kryetari i Komunës merr këtë:

### V E N D I M P E R F O R M I M T Ë K O M I S I O N I T

- 1 Formohet komisioni për shqyrtim të kërkesave – aplikacioneve për subvencionim të ujitjes së tokave bujqësore në këtë përbërje:
  - 1.1 Avdyl Feka, kryesues i komisionit,
  - 1.2 Ragbete Krasniqi, anëtare,
  - 1.3 Agim Miftari, anëtare.
- 2 Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të shqyrtoj, aplikacionet për subvencionim të ujitjes së tokave bujqësore në vitin 2024 bazuar në marrëveshjen e nënshkruar në mes të NH “Ibër Lepenc” për realizimin e projektit për ujitjen e kulturave bujqësore në Komunën e Vushtrrisë.
- 3 Mandati i komisionit përfundon me përfundimin e implementimit të kësaj marrëveshje.
- 4 Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës

#### Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorit për EBPZHR
- Anëtarëve të komisionit dhe
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRIN

02 Nr. / Br 1683/24

Nr. i fq. / Br. sh \_\_\_\_\_

Data: / Datum 11.11.2024

VUSHTRRI - VUČITRIN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 19 të Rregullores MF – Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, nenin 43 paragrafi 14 dhe 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, nenin 21 paragrafi 5 të Rregullës për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare të Komunës nr.1546/24 dt.20.09.2024, si dhe bazuar në propozimin e Drejtores së Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare datë 11 nëntor 2024, Kryetari i Komunës merr këtë:

### V E N D I M

#### PËR THEMELIM TË KOMISIONIT PËR INVENTARIZIM TË PASURISË JO FINANCIARE NË INSTITUCIONET SHËNDETËSORE TË KOMUNËS

1. Themelohet komisioni për inventarizim të pasurisë jo financiare në Institucionet Shëndetësore të Komunës, në këtë përbërje:
  - 1.1 Adlije Shaqiri, kryesuese e komisionit
  - 1.2 Mentor Hasani, anëtar
  - 1.3 Esat Uka, anëtar
2. Komisioni i cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të kryej inventarizimin në institucionet publike të administratës së komunës, në pajtim me Rregulloren e MF – Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore përkatësisht Rregullën e aprovuar nga Kryetari i Komunës për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare të Komunës nr.1546/24 dt.20.09.2024.
3. Komisioni obligohet që para se të fillojë me verifikimin fizik të inventarit, të bashkëpunojë me zyrtarin e pasurisë dhe zyrtarin e pranimit/logjistikës në nxjerrjen e informatave të përditësuara nga regjistri E/pasuria dhe regjistri alternativ i të dhënave (excel) për çka obligohen për harmonizim.
4. Komisioni duhet të filloj me punë menjëherë dhe paraqes raport për inventarizim para datës 31 dhjetor 2024 Kryetarit të Komunës.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Vendimi iu dërgohet:

- Drejtores së QKMF-së
- Anëtarëve të komisionit
- Arkivit

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPSTINA VUCITRIN

02 Nr. / Br 1691/24

Nr. i fq. / Br. st

Data: / Datum 12.11.2024

VUSHTRRI - VUCITRIN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI  
Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 19 të Rregullores MF – Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, nenin 43 paragrafi 14 dhe 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, nenin 21 paragrafi 5 të Rregullës për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare të Komunës nr.1546/24 dt.20.09.2024, si dhe bazuar në propozimin e Drejtores së Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare datë 11 nëntor 2024, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR THEMELIM TË KOMISIONIT PËR INVENTARIZIM TË PASURISË JO FINANCIARE**  
**NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË KOMUNËS**

1. Themelohet komisioni për inventarizim të pasurisë jo financiare në Institucionet Arsimore të Komunës, në këtë përbërje:
  - 1.1 Enver Bajrami, kryesues i komisionit
  - 1.2 Sadete Gërguri, anëtare
  - 1.3 Edona Shotani, anëtare
2. Komisioni i cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të kryej inventarizimin në institucionet publike në Institucione Arsimore të komunës, në pajtim me Rregulloren e MF – Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore përkatësisht Rregullën e aprovuar nga Kryetari i Komunës për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare të Komunës nr.1546/24 dt.20.09.2024.
3. Komisioni obligohet që para se të fillojë me verifikimin fizik të inventarit, të bashkëpunojë me zyrtarin e pasurisë dhe zyrtarin e pranimit/logjistikës në nxjerrjen e informatave të përditësuara nga regjistri E/pasuria dhe regjistri alternativ i të dhënave (excel) për çka obligohen për harmonizim.
4. Komisioni duhet të filloj me punë menjëherë dhe paraqes raport për inventarizim para datës 31 dhjetor 2024 Kryetarit të Komunës.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



**Ferit Idrizi**

**Kryetar i Komunës**

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtores së QKMF-së
- Anëtarëve të komisionit
- Arkivit

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUÇITRAN

02 Nr. / Br 1694/24


Nr. i fq. / Br. st \_\_\_\_\_

Data: / Datum 15.11.2024

VUSHTRRI - VUÇITRAN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI  
Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dhe nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË VENDIMIT**

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi 02Nr. 1676/24 datë 08.11.2024, për themelim të komisionit për inventarizim të pasurisë jofinanciare në administratën e komunës ku në vend të z. Mentor Jasharit caktohet z. Fitim Klinaku.
2. Pikët tjera të vendimit mbesin të pa ndryshuara.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Ferit Idrizi**  
  
Kryetar i Komunës



Vendimi iu dërgohet:

- Z. Fitim Klinaku
- Arkivit

REPublika e Kosovës - Republika Kosovo  
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN

02 Nr. / Br 1676/24

Nr. i fq. / Br. st \_\_\_\_\_

Data: / Datum 08-11-2024

VUSHTRRI - VUČITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI  
Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 19 të Rregullores MF – Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, nenin 43 paragrafi 14 dhe 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, nenin 21 paragrafi 5 të Rregullës për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare të Komunës nr.1546/24 dt.20.09.2024, si dhe bazuar në propozimin e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa datë 06 nëntor 2024, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR THEMELIM TË KOMISIONIT PËR INVENTARIZIM TË PASURISË JO FINANCIARE**  
**NË ADMINISTRATËN E KOMUNËS**

1. Themelohet komisioni për inventarizim të pasurisë jo financiare në Administratën e Komunës, në këtë përbërje:
  - 1.1 Mentor Jashari, kryesues i komisionit
  - 1.2 Shqipe Xhema, anëtare
  - 1.3 Jakup Qyqalla, anëtar
2. Komisioni i cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të kryej inventarizimin në institucionet publike të administratës së komunës, në pajtim me Rregulloren e MF – Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore përkatësisht Rregullën e aprovuar nga Kryetari i Komunës për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare të Komunës nr.1546/24 dt.20.09.2024.
3. Komisioni obligohet që para se të fillojë me verifikimin fizik të inventarit, të bashkëpunojë me zyrtarin e pasurisë dhe zyrtarin e pranimit/logjistikës në nxjerrjen e informatave të përditësuara nga regjistri E/pasuria dhe regjistri alternativ i të dhënave (excel) për çka obligohen për harmonizim.
4. Komisioni duhet të filloj me punë menjëherë dhe paraqes raport për inventarizim para datës 31 dhjetor 2024 Kryetarit të Komunës.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit
- Zyrtarit të pasurisë
- Arkivit

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRIN

02 Nr. / Br 1710/24

Nr. i fq. / Br. st \_\_\_\_\_

Data: / Datum 19.11.2024

VUSHTRRI - VUÇITRIN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI  
Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 4 të Ligjit nr. 08/L-193 mbi ndarjen buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar, nenit 84 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 6 të Ligjit nr. 08/L-183 për Mbështetjen e Punëve Publike, dhe nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, me rekomandim të menaxherit të kontratës, Kryetari i Komunës merr këtë:

**VENDIM APROVUES**

1. APROVOHET kërkesa e Operatorit Ekonomik (OE) N.N.P. "WENDA" për kompensim në kontratën e lidhur për projektin "*Intervenime në raste emergjente*", me Nr. Prokurimi VU644-20-7028-5-2-1.
2. Kërkesa e aprovuar në pikën 1. të këtij vendimi bazohet në kërkesën e dorëzuar nga Operatori Ekonomik të pranuar në afatin ligjor, e shqyrtuar dhe rekomanduar nga menaxheri i kontratës. Menaxheri i kontratës për mbikëqyrjen e punimeve i caktuar si organ mbikëqyrës, ka bërë përlllogaritjen e kompensimit bazuar në kalkulatorin e publikimit nga MFPT i cili është publik në harmoni me rritjen çmimeve të përcaktuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës ku është specifikuar rritja e çmimeve për produktet e referuara sipas nenit 4 të ligjit nr. 08/L-183 për mbështetjen e punëve publike.
3. *Shuma e aprovuar që ndikohet nga ky ligj është: 3,245.00 € (tremijëedyqindedyzetepesë euro).*
4. Mjetet financiare nga pika paraprake e këtij vendimi të paguhen nga buxheti i Drejtorisë për Arsim.
5. Obligohet Zyra e Prokurimit që këtë vendim ta vendosë në platformën elektronike të prokurimit publik.
6. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.



Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Arsim
- Drejtorisë për Prokurim Publik
- Arkivit



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 1725/24

Nr. i fq. / Br. st

Data: / Datum 22.11.2024

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenin 43 paragraf. 14 dhe 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës dhe nenin 19 paragrafi 19.16 të Rregullores të KRPP Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, si dhe propozimit të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dt. 22.11.2024, Kryetari i Komunës merr këtë:

### V E N D I M

1. Znj. Anila Bregaj, caktohet zyrtare e autorizuar për **Hartimin e Specifikimeve teknike/termat e referencës** për aktivitetin e prokurimit: Furnizim me pajisje mjekësore për nevojat e QKMF-së "Safet Idrizi" në Vushtri.
2. Zyrtarja nga pika paraprake e këtij vendimi obligohet që të hartoj Specifikimet Teknike në pajtim me Ligjin për Prokurim Publik dhe Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit të emëruar janë që të harton specifikimet teknike/TeR:
  - 3.1 Në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtura drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik, në përputhje me nenin 28 të Ligjit të Prokurimit Publik, Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 dhe legjislacionin dytësor;
  - 3.2 Në atë mënyre që nuk favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik;
  - 3.3 Të cilat nuk i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi.
  - 3.4 Zyrtari i emëruar obligohet gjithashtu që specifikimet teknike t'i hartoj deri me datë 25.11.2024.
  - 3.5 Bashkëngjitur me specifikimet teknike duhet të dorëzoj edhe Deklaratën e nënshkruar nën Betim.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
Ferit Idrizi  
Kryetar i Komunës

#### Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale
- Drejtorisë për Prokurim Publik
- Znj. Anila Bregaj
- Arkivit



REPubLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUŠTRRI  
02 Nr. / Br 1743/24  
Nr. i fq. / Br. st \_\_\_\_\_  
Data: / Datum 27.11.2024  
VUSHTRRI - VUŠTRRI

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenin 43 paragr. 14 dhe 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

### V E N D I M PËR THEMELIM TË GRUPIT PUNUES

1. Me këtë vendim themelohet grupi punues për bashkëpunim me operatorin ekonomik për hartimin e Profilit të Komunës.
2. Në përbërje të grupit punues caktohen:
  - 2.1 Islam Latifi, anëtar
  - 2.2 Bekim Selmani, anëtar
  - 2.3 Sadete Gërguri, anëtare
  - 2.4 Gëzim Saraçi, anëtar
  - 2.5 Albiona Isa, anëtare
  - 2.5 Tefik Maloku, anëtar
  - 2.6 Bajram Beqiri, anëtar
  - 2.7 Qemajl Hasani, anëtar
  - 2.8 Fisnik Kamberi, anëtar
  - 2.9 Ajtene Ternava-Salihu, anëtare
  - 2.10 Pranvera Neziri Merovci, anëtare
  - 2.11 Izet Krasniqi, anëtar
3. Grupi punues në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të bashkëpunojë ngushtë me përfaqësuesin e operatorit ekonomik i kontraktuar nga komuna si dhe menaxherin e kontratës për hartimin e profilit të komunës. Anëtarët e grupit punues gjatë punës së tyre duhet ofruar të dhëna të nevojshme nga fushat përkatëse të cilat janë të domosdoshme për të u përfshi në dokumentin – Profili i Komunës së Vuštrri.
4. Grupi punues në kërkesë të operatorit ekonomik dhe menaxherit të kontratës janë të obliguar të marrin pjesë në takimet që do të caktohen nga menaxheri i kontratës në koordinim me përfaqësuesin e operatorit ekonomik për të diskutuar deri në detaje të dhënat relevante që do të shërbenin për të inkorporuar në draftin e dokumentit në fjalë.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të grupit punues
- Menaxherit të kontratës
- Arkivit



Ferit Idrizi  
Kryetar i Komunës